REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME**
**AGJENCIA E BLERJEVE TË PËRQENDRUARA**

# FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

*[Data: 28.09.2020]*

Për: **"EURO MEGA 2010" SHPK**.
Adresa: *TIRANE,* Preze AHMETAQ Fshati Ahemtaq, prane firmes Ital Kon.

Për: **"ATLANTIK 3" SHPK**
Adresa: VORE Autostrada Tirane - Durres, Km. 10, Rruga dytesore Vore - Albania

* * *

Proçedura e prokurimit: **"Procedurë e hapur"- Mallra -** Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara me objekt: **"Blerje materiale të ndryshme për pastrim (e ndarë në 3 Lote, përfshirë artikujt kundër COVID-19)",** me fond të përgjithshëm të marrëveshjes kuadër: **34,243,775 (tridhjetë e katër milion e dyqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë) Lekë (pa TVSH),** me numër reference: **REF-67600-08-03-2020:**

Përshkrim i shkurtër i kontratës së **Lotit I** me numër reference **REF-67602-08-03-2020, "Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues"** me fond limit të marrëveshjes kuadër **5,650,448 (*pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e tetë)* Lekë, (pa TVSH)** Marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomik, ku jo të gjitha kushtet janë të përcaktuara dhe me afat kohor për ekzekutimin: Duke filluar nga data e lidhjes së kontratës/kontratave sipas kërkesës se Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 24 (njëzet e katër) muaj të lidhjes së Marrëveshjes Kuadër.

Publikime të mëparshme *(jo):* Buletini i Njoftimeve Publike *10.08.2020, Nr.53.*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët x

**Për lotin I:** Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1) **"MURATI D" SHPK** **K42003004T**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **2,370,625 (**dy milion e treqind e shtatëdhjet mijë e gjashtëqindë e njëzet e pesë) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë)*

2) **"EURO MEGA 2010" SHPK.** **K91624505A**

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Vlera: **2,995,925** (dy milion e nëntëqindë e nëntëdhjet e pesë mijë e nëntëqindë e njëzet e pesë) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

3) **"ATLANTIK 3" SHPK**. **K22218003V**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **3,974,650** (tre milion e nëntëqindë e shtatëdhjet e katër mijë e gjashtëqindë e pesëdhjet) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

4) **"4 S" SHPK.** **L64425401K**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **4,237,900** (katër milion e dyqindë e tridhjet e shtatë mijë e nëntëqind) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

5) **"PASTRIME SILVIO" SHPK.** **K91413010N**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **5,159,725** (pesë milion e njëqindë e pesëdhjet e nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

6) **"SHPIRAGU" SHPK.** **J81503005U**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **5,192,102** (pesë milion e njëqindë e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e dy) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

7) **"LEON GROUP" SHPK.** **L51313013I**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **5,241,225** (pesë milion e dyqindë e dyzet e një mijë e dyqindë e njëzet e pesë) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

8) **"ALPEST".** **M01714005H**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **0.0** (zero) lekë, pa TVSH.
*(me numra dhe fjalë).*

*Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhtëm:*

1) **"MURATI D" SHPK** **K42003004T**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2) **"4 S" SHPK**. **L64425401K**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**3) “PASTRIME SILVIO" SHPK** **K91413010N**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**4) "SHPIRAGU" SHPK** **J81503005U**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**5) "LEON GROUP" SHPK** **L51313013I**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

**6) "ALPEST"** **M01714005H**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

1) Arsyet e skualifikimit për**: "MURATI D" SHPK**

- Nuk plotëson gërmën b (*Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1)*, pika 2, “ Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi ka përcaktuar të dyja alternativat **a** dhe **b**, të pikës 6, të kësaj deklarate.
- Nuk plotëson pikën 3 gërma e), seksioni 2.3 “Kapaciteti teknik”, pika **2**, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë Certifikatë për transport mallrash në emër të tij. Në rastin konkret përmes dokumentacionit të dorëzuar vërtetohet se çertifikata e mjetit me targë AA267OJ të cilën e disponon shoqëria “Frutibest” sipas lejes së qarkullimit, është specifike dhe e lëshuar për kryerjen e transportit të mallrave, brenda vendit, vetëm për llogari të veprimtarisë së vet. Në këtë mënyrë, kryerja e transportit të mallrave nga ana e operatorit ekonomik “Murati D” shpk me kamionin e shoqërisë “Frutibest” do të jetë në kushtet e kryerjes së transportit të mallrave me qira dhe për të tretë pa licencën përkatëse, transport i cili në zbatim të nenit 41 të ligjit “Për Transportet Rrugore” është i ndaluar.

2) Arsyet e skualifikimit për**: "4 S" SHPK**

- Nuk plotëson pikën 1 gërma a) të Kritereve të vecanta për kualifikim (Formularin e ofertës sipas shtojcës 1), pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk ka paraqitur tabelat e vecanta të autoriteteve kontraktore, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Shtojcën 1 të DST ku parashikohet se: “*Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë të gjitha tabelat, si tabelën e përgjithshme dhe tabelat e veçanta të autoriteteve kontraktore me të dhënat e paraqitura dhe për artikuj të njëjtë të ofertojnë me çmim të njëjtë, pa tejkaluar fondin e marrëveshjes kuadër të cdo autoriteti, në të kundërt oferta e tyre do të konsiderohet e pavlefshme*.

3) Arsyet e skualifikimit për**: "PASTRIME SILVIO" SHPK**

- Nuk plotëson pikën 1 gërma a) të Kritereve të vecanta për kualifikim (Formularin e ofertës sipas shtojcës 1), pasi në momentin e hapjes së ofertave, në tabelat e vecanta të autoriteteve kontraktore Drejtoria e Shërbimit Spitalor Rajonal Durrës, Garda e Republikës dhe Drejtoria e përgjithshme e Përmbarimit, ka ofertuar me cmime të ndryshme, në krahasim me tabelën e përgjithshme, për zërin “Solucion larës dyshemeje”, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Shtojcën 1, të DST, ku parashikohet se: “*Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë të gjitha tabelat, si tabelën e përgjithshme dhe tabelat e veçanta të autoriteteve kontraktore me të dhënat e paraqitura dhe për artikuj të njëjtë të ofertojnë me*

*çmim të njëjtë, pa tejkaluar fondin e marrëveshjes kuadër të cdo autoriteti, në të kundërt oferta e tyre do të konsiderohet e pavlefshme*”**.**

4) Arsyet e skualifikimit për**: "SHPIRAGU" SHPK**

- Nuk plotëson *gërmën **a** (*Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore lëshuar nga administrata tatimore), pika **4**, seksioni ***2.3***, “Kapaciteti teknik”, pika **2**, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë Vërtetimin për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, lëshuar nga administrata tatimore.
- Nuk plotëson *gërmën **a** (*Kontratë noteriale qiraje të ambientit të magazinimit), pika **2**, seksioni ***2.3*** “Kapaciteti teknik”, pika **2** “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të paraqesë Kontratë noteriale qiraje, për ambientin e magazinimit. Kontrata e qirasë, e paraqitur, nuk është e lidhur para noterit.

5) Arsyet e skualifikimit për**: "LEON GROUP" SHPK**

- Nuk ka plotësuar shtojcën 8 “Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme” sipas formatit të kërkuar në DST, pasi mungojne te dhenat per administratorin e shoqerise Z. E. Lumshi.
- Nuk plotëson gërmën b (*Deklarate për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1),* pika 2, “ Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi nuk ka përcaktuar asnjë nga alternativat a dhe b, të pikës 6, të kësaj deklarate.
- Nuk plotëson gërmen **f (***Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri), pika* **2**, **“**Kriteret e veçanta të kualifikimit**”,** pasi në momentin e hapjes së ofertave nuk arriti paraqesë shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë, që ka operatori ekonomik, që është i regjistruar në Shqipëri për muajin Qershor 2020.
- Nuk plotëson *gërmën **c** (*Certifikatë e kontrollit teknik, të mjeteve rrugore)***, d** *(*Policë, për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve), pika **3**, seksioni ***2.3***, “Kapaciteti teknik”, pika **2**, “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pasi në momentin e hapjes së ofertave, nuk arriti të justifikojë vlefshmërinë e Certifikatës së kontrollit teknik dhe Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve, pasi ato kanë përfunduar afatin e vlefshmërinë së tyre, përkatësisht më datë 06.06.2020 Certifikata e kontrollit teknik dhe më datë 13.05.2020 Polica për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve.
- Ka gabime aritmetike tek Formulari i Ofertës Shtojca 1, si në tabelën e përgjithshme ashtu edhe në tabelat e vecanta të autoriteteve kontraktare, duke tejkaluar edhe fondet limite të marrëveshjes kuadër të Autoriteteve Kontraktore: Drejtoria e Shërbimit Spitali Rajonal Durrës, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave të Shtetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Permbarimit Tirane, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në Shtojcën 1 të DST ku parashikohet se: “*Operatorët ekonomik duhet të plotësojnë të gjitha tabelat, si tabelën e përgjithshme dhe tabelat e veçanta të autoriteteve kontraktore me të dhënat e paraqitura dhe për artikuj të njëjtë të ofertojnë me çmim të njëjtë, pa tejkaluar fondin e marrëveshjes kuadër të cdo autoriteti, në të kundërt oferta e tyre do të konsiderohet e pavlefshme*”.

6) Arsyet e skualifikimit për**: "ALPEST"**

- Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike, dhe as asnjë nga dokumentet e kërkuara në DST

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomik të suksesshëm:

**1) "EURO MEGA 2010"** **K91624505A**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **2,995,925** (dy milion e nëntëqindë e nëntëdhjet e pesë mijë e nëntëqindë e njëzet e pesë) lekë, pa TVSH. *(me numra dhe fjalë).*

**2) "ATLANTIK 3" SHPK**. **K22218003V**
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera: **3,974,650** (tre milion e nëntëqindë e shtatëdhjet e katër mijë e gjashtëqindë e pesëdhjet) lekë, pa TVSH. *(me numra dhe fjalë).*

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqiteni pranë organit qendror blerës Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me adresë: Ministria e Brendshme, Sheshi Skënderbej, nr.3, Tiranë, Tel: 042247865, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi, për të lidhur marrëveshjen kuadër.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 16.09.2020
Ankesa: JO

**TITULLARI I ORGANIT QENDROR BLERËS**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**